V E N D I M
Nr.42, datë 28.1.1999

PËR KRIJIMIN E BORDIT PËR REFORMËN INSTITUCIONALE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Bordit për Reformën Institucionale dhe Administratën Publike, me këtë përbërje:

- zëvendëskryeministri dhe ministri i Koordinimit Qeveritar — Kryetar
- ministri për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin — anëtar
- ministri i Financave — anëtar
- ministri i Drejtësisë — anëtar
- drejtori i Departamentit të Administratës Publike — anëtar

2. Kryetari i Bordit thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit sipas rendit të ditës të propozuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe miratuar prej tij.

3. Bordi mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj.

4. Zëvendëskryeministri, në përputhje me strategjinë e reformës institucionale e të administratës publike dhe me përparësitë e programit qeveritar, cakton anëtarët e përkohshëm të bordit ndërministror.

Në mbledhjet e bordit ndërministror, me miratimin e kryetarit, mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë, sipas çështjeve që shqyrtohen.

5. Në mbledhjet e bordit ndërministror mund të ftohen përfaqësues të dikastereve, të institucioneve dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në varësi të çështjeve që diskutohet.

6. Bordi shqyrton çështje, që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e masave, me kuadrin ligjor dhe strategjinë e zhvillimit, që duhen ndërmarrë për reformën institucionale dhe administratën publike. Bordi shqyrton propozimet për projektligje e projektvendime, të cilat lidhen me këto fusha.

7. Bordi ka këto kompetenca:

- Mbështetur në programin e Qeverisë, harton dhe përcakton përparësitë për reformën institucionale dhe administratën publike.
- Siguron koordinimin dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Mbikëqyrë zhvillimin e procesit të reformës, për zbatimin e orientimeve, standardeve dhe procedurave dhe bën publikimin e rezultateve.
- Bashkëpunon me donatorët në procesin e reformës institucionale dhe informon për ecurinë e reformës.

8. Departamenti i Administratës Publike përmbush detyrat e sekretarisë teknike të bordit ndërministror dhe ka për detyrë hartimin e materialeve të mbledhjes, raportimin në mbledhje, si dhe monitorimin dhe përgatitjen e rekomandimeve, mbështetur në punën e bërë nga grupet e punës të përfshira në procesin e reformës institucionale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTËR I KOORDINIMIT QEVERITAR
Ilir Meta

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko